

Vendim nr. 272 datë 12.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 12.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (SH) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “SGS AUTOMOTIVE ALBANIA” SH.P.K.**, përfaqësuar nga avokat Arben Kashahu, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 6409, datë 10.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 00-2024-2146 (202), datë 09.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 1, 2, 3, 25, 27, 31, 71, 71/a, 71/b, 72 dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “SGS Automotive Albania” sh.p.k (*kërkuesja*), është person juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore sipas kontratës së koncesionit “Për shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, të nënshkruar në datën 03.09.2009 me autoritetin kontraktues, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj (*DRTTM*) ka ushtruar kontroll ndaj kërkueses, sipas aktit të lajmërimit dhe autorizimit nr.10139/1, datë 04.09.2013. Në përfundim të kontrollit, DRTTM-ja ka nxjerrë njoftimvlerësimin tatimor nr. 10139/5 prot., datë 25.11.2013 (*njoftimvlerësimi tatimor*), përmes të cilit shoqëria është ngarkuar me detyrime dhe gjoba, në një vlerë totale prej 11.103.939 lekësh. Detyrimet janë nxjerrë, për sa i përket shërbimit të marrë nga shoqëria, në shumën prej 17.522.641 lekësh nga furnitori i huaj, shoqëria “V”, në lidhje me instalimin/montimin e linjave teknologjike për inspektimin e automjeteve në stacionin e inspektimit të makinave.

3. Sipas DRTTM-së, referuar raportit të kontrollit, shërbimi i ofruar nga shoqëria “V” për instalimin/montimin e linjave të inspektimit në stacionin e inspektimit të makinave, është shërbim që ka të bëjë me pasurinë e paluajtshme dhe, për pasojë, shoqëria “V” duhet të kishte regjistruar një përfaqësues tatimor në Shqipëri, i cili do të mbulonte detyrimet e tij për tatimin mbi vlerën e shtuar (*TVSH*). Si rrjedhim, për këto shërbime duhet të ishin lëshuar fatura tatimore me TVSH nga përfaqësuesi tatimor i shoqërisë “V” dhe jo autofatura nga kërkuesja. Për këtë arsye, kërkuesja është ngarkuar për vlerën e detyrimeve tatimore, përveçse edhe me gjoba, sikundër edhe me kamatëvonesa.

4. Njoftimvlerësimin tatimor kërkuesja e ka ankimuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor (*DAT*), e cila, me vendimin nr. 22626/5 prot., datë 24.04.2014, ka vendosur të lërë në fuqi detyrimet tatimore, gjobën dhe kamatëvonesën, objekt ankimi. Në vijim, në datën 29.05.2014, kërkuesja ka paraqitur kërkesëpadi, me objekt shfuqizimin e pjeshëm të akteve administrative, njoftimvlerësimin tatimor dhe vendimit nr. 22626/5 prot., datë 24.04.2014 të DAT-së, si dhe rregullimin e pasojave të shfuqizimit të këtyre akteve administrative dhe dëmshpërblimin e saj.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6409, datë 10.11.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pambështetur në ligj dhe në prova. Ajo gjykatë ka arsyetuar se vetë kërkuesja e ka kategorizuar instalimin e linjave si aktiv të qëndrueshëm të trupëzuar (*AQT*) e, për pasojë, ky klasifikim ka sjellë trajtimin e tyre nga ana e organeve tatimore si pasuri të paluajtshme. Gjithashtu, gjykata ka arsyetuar se në kushtet kur instalimi i

linjave të inspektimit në shumën 17.522.641 lekë, mbi të cilat është kryer vlerësimi tatimor, janë konsideruar si shërbim i lidhur me pasurinë e paluajtshme, duke qenë se shoqëria ofruese e shërbimit “V” nuk ka përfaqësues ligjor në territorin e Republikës së Shqipërisë, detyrimi tatimor mbledhet ndaj përfituesit vendas të furnizimit, konkretisht ndaj kërkueses. Në lidhje me penalitetin e aplikuar, gjykata argumenton se duhej të ishte lëshuar faturë nga shoqëria jorezidente (shoqëria “V”) dhe në kushtet kur kjo nuk ka ndodhur, penalizimi përkatës i parashikuar nga ligji për moslëshim të faturës tatimore i takon kërkueses. Gjykata, po kështu, ka vlerësuar se në kushtet kur qëndron detyrimi tatimor, për paligjshmëri të të cilit pretendohen interesat si dëmshpërblim, nuk ka vend për pranimin e pretendimit për dëmshpërblim, ndërsa ai është rrjedhojë e kërimit kryesor për paligjshmërinë e akteve administrative. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1277, datë 28.03.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, pranimin e kërimit të padisë për shfuqizimin e pjesshëm të akteve administrative, të njoftimvlerësimit tatimor dhe të vendimit nr. 22626/5 prot., datë 24.04.2014 të DAT-së, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për sa i takon kërimit për dëmshpërblim. Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj ka arsyetuar se fakti që vetë kërkuesja instalimin e linjave të inspektimit e ka kategorizuar si AQT, nuk do të thotë se ato janë pasuri të paluajtshme, pasi kriteri i kategorizimit jepet në Kodin Civil. Gjithashtu, organet tatimore nuk e kanë vlerësuar drejt mekanizmin e autofaturimit të aplikuar nga kërkuesja, pasi ka rezultuar e provuar se përfituesja e shërbimeve, kërkuesja, i ka paguar të gjitha detyrimet edhe në emër të shoqërisë jorezidente “V”, nëpërmjet autofaturimit. Nga ky fakt nuk ka lindur asnjë detyrim tatimor shtesë dhe shtetit nuk i është shkaktuar dëm ekonomik. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurse DRTTM-ja dhe Avokatura e Shtetit, ndërsa në datën 15.06.2017 kërkuesja ka paraqitur kundërrekurs.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-2146 (202), datë 09.05.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se rekursat e paraqitura nga DRTTM-ja dhe Avokatura e Shtetit paraqesin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), duke vlerësuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka interpretuar drejt ligjin e zbatueshëm. Sipas saj, në interpretim të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar (ligji nr. 7928/1995) dhe akteve në zbatim të tij, furnizimi i shërbimeve në lidhje me pasurinë e paluajtshme kryhet atje ku gjendet pasuria e paluajtshme,

ndaj duke qenë se ajo, në rastin konkret, gjendet në Republikën e Shqipërisë, atëherë shërbimi konsiderohet të jetë kryer në Shqipëri. Nga ana tjetër, në kushtet kur furnitori jorezident “V” nuk ka pasur një përfaqësues tatimor në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 55 të ligjit nr. 7928/1995, përgjegjësia tatimore i ngarkohet subjektit përfitues vendas, i cili përgjigjet për të gjitha detyrimet dhe penaltitetet në lidhje me to. Për rrjedhojë, në procedurën për nxjerrjen e aktit administrativ të njoftimvlerësimit tatimor nuk evidentohen shkelje të ligjit nga organi publik, i cili ka vepruar brenda sferës së kompetencave dhe të përgjegjësisë së tij administrative.

8. Në datën 06.09.2024 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkueses

9. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t’u dëgjuar drejtësisht*, pasi pavarësisht se është ushtruar kundërrekurs ndaj rekurseve të palëve të paditura, DRTTM-së dhe Avokaturës së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka analizuar elementet e kundërrekursit, duke u mjaftuar me trajtimin e provave dhe vlerësimin e tyre në të njëjtën linjë me gjykatën e shkallës së parë. Në këtë rast, qëndrimi i Kolegjit Administrativ bie ndesh me praktikën e tij. Gjithashtu, e drejta për t’u dëgjuar ushtrohet edhe nëpërmjet parashtrimit të qëndrimit dhe të kundërshtimeve në formë të shkruar, të cilat duhet të ishin marrë në konsideratë nga Gjykata e Lartë.

9.1.2. *Së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi: (i) Gjykata e Lartë ka marrë përsipër të bëjë interpretimin dhe kualifikimin e fakteve dhe provave, kompetencë e cila ushtrohet nga gjykatat e faktit. Ajo gjykatë e ka bazuar vendimin në analizimin e provave, në një kohë kur ajo është një gjykatë ligji. Ky fakt vërtetohet nga paragrafi 21 i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; (ii) nuk është respektuar neni 58/b i ligjit nr. 49/2012, pasi vendimi i gjykatës së apelit është marrë në përputhje me vendimmarrje të mëparshme të Gjykatës së Lartë (*vendimi nr. 00-2015-3910 (636), datë 25.11.2015*). Në këtë mënyrë është cenuar edhe parimi i sigurisë

juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme për trajtimin e barabartë dhe uniformitetin në zbatimin e ligjit për raste të njëjta ose analoge.

9.1.3. *Së drejtës së gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi kontrolli i saj nga DRTTM-ja është bërë në vitin 2013, ndërkohë që përmbyllja e procesit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Lartë është bërë në vitin 2024, pra pas rreth 11 vjetësh.

9.2. *E drejta e pronës*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se është i drejtë vendimi i gjykatës së shkallës së parë, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit, ka interpretuar gabim ligjin material tatimor, duke i shkaktuar një dëm pasuror të qenësishëm.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000,

përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

13. Kolegji konstaton se kërkuesja ka pretenduar se kontrolli i saj nga DRTTM-ja është bërë në vitin 2013, ndërkohë që përmbyllja e procesit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Lartë është bërë në vitin 2024, pra pas rreth 11 vjetësh. Në lidhje me pretendimin për zhvillimin e një procesi tej afatit të arsyeshëm, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC) që kanë hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2017, parashikojnë mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, në këto dispozita përcaktohet kuptimi i afateve të arsyeshme (neni 399/2), mjetet e mbrojtjes nga cenimi, kërkesa për përshpejtimin e gjykimit (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe kuptimi i shpërblimit të drejtë (neni 399/3), përcaktohet gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nisur nga sa më lart, edhe pse kërkuesja ka pretenduar kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit në tërësinë e tij, nuk rezulton që në ndonjë fazë të caktuar ajo t'i jetë drejtuar gjykatës kompetente me kërkesë për konstatimin e gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399/6 të KPC-së. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim, prandaj nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkueses, Kolegji vëren se ato kanë lidhje me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ato përmbushin kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja ka përfunduar me vendimin e datës 09.05.2024 të Gjykatës së Lartë, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 06.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar, së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe së drejtës së pronës, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues. Në lidhje me pretendimet për të drejtën e pronës, Kolegji mban në konsideratë se argumentet e dhëna nga kërkesja lidhen tërësisht me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj, për rrjedhojë çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar

18. Kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, pasi, pavarësisht se nga ana e saj është ushtruar kundërrkurs ndaj rekurseve të palëve të paditura, DRTTM-së dhe Avokaturës së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka analizuar elementet e tij, duke u mjaftuar me trajtimin e provave dhe vlerësimin e tyre në të njëjtën linjë me gjykatën e shkallës së parë. Qëndrimi i Kolegjit Administrativ në këtë rast bie ndesh me praktikën e tij. Gjithashtu, sipas kërkeses, e drejta për t'u dëgjuar ushtrohet edhe nëpërmjet parashtrimit të qëndrimit dhe të kundërshtimeve në formë të shkruar, që është një nga elementet e kontradiktoritetit në një proces të rregullt ligjor, dhe, si të tilla duhet të ishin marrë në konsideratë nga Gjykata e Lartë.

19. Gjykata ka pohuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit përbën një aspekt të saj. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr.7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e

dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr.43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkueses, në rastin në shqyrtim, Kolegji do të analizojë nëse kërkueses i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, duke sjellë, si pasojë, cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, në kuptim të marrjes nga Gjykata e Lartë të një zgjidhjeje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

21. Sikurse u theksua në rrethanat e çështjes (*shih paragrafin 6*), ndaj vendimit të gjykatës së apelit, e cila ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë e kërkueses në lidhje me pretendimet për shfuqizimin e pjesshëm të akteve administrative të DRTTM-së dhe të DAT-së, kanë ushtruar rekurse DRTTM-ja dhe Avokatura e Shtetit, ndërsa kërkuësja ka paraqitur kundërrekurs. Ky fakt është pasqyruar edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 13 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këtë kuptim, Kolegji çmon se kërkueses i është garantuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës me kundërrekurs për të kundërshtuar rekursin e paraqitura nga pala kundërshtare. Për sa i takon përmbajtjes së kundërrekursit, Kolegji vëren se ai nuk paraqet qëndrime ose fakte të reja nga ato të paraqitura nga kërkuësja në kërkesëpadinë e saj dhe, më pas, në ankimin ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe që lidhen me zbatimin e ligjit material.

22. Ndërkohë Gjykata e Lartë, në vendimin e saj, pasi ka analizuar qëllimin e sistemit tatimor dhe ligjin nr.7928/1995 “Për TVSH-në”, si dhe udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, ka vlerësuar se çështja që shtrohet për diskutim lidhet me regjimin juridik të zbatueshëm në rastin e shërbimeve të përfituara në lidhje me instalimin e linjave teknologjike për inspektimin e automjeteve nga furnitori i huaj jorezident. Ajo ka analizuar vendimet e gjykatave të faktit, duke arsyetuar se përse duhet lënë në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Në këtë pikëpamje, pavarësisht se në dukje vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk u jep përgjigje direkte pretendimeve të paraqitura në kundërrekurs, në arsyetimin e saj, ajo gjykatë, nëpërmjet dhënies përgjigje të shkaqeve të rekursit të palëve të paditura, si dhe duke marrë në shqyrtim vendimet e gjykatave të faktit, i ka dhënë përgjigje edhe kërkueses për shkaqet e kundërrekursit.

23. Nisur nga sa më sipër, në kushtet kur në kundërrekurs argumentet e dhëna kanë lidhje me zgjidhjen e çështjes në themel dhe nuk parashtrohen qëndrime që nuk janë paraqitur më parë nga kërkuësja, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se Gjykata e Lartë nuk ka vënë në diskutim çështje të reja nga ato të shqyrtuara në gjykatat e faktit, Kolegji vlerëson se ajo gjykatë u ka dhënë përgjigje edhe pretendimeve të kërkueses, duke zgjidhur themelin e çështjes.

24. Lidhur me pretendimin se qëndrimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për këtë rast bie ndesh me praktikën e vetë atij, Kolegji vëren se nuk rezulton që Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj të ketë vendosur në mënyrë të ndryshme me ndonjë vendim unifikues a njësuës të praktikës gjyqësore, për rrjedhojë fakti që Kolegji Administrativ i asaj gjykate mund të ketë vendosur ndryshe në raste të ngjashme, nuk përbën argument që të cenojë procesin nga pikëpamja kushtetuese. Sikurse është shprehur edhe Gjykata në jurisprudencën e saj, kur kërkuesit kanë pretenduar cenimin e procesit të rregullt në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Nisur nga këto konsiderata, Kolegji vëren se kërkuesja e ka ushtruar lirisht të drejtën e saj të aksesit nëpërmjet paraqitjes së kundërrekursit në Gjykatën e Lartë dhe nuk rezulton që asaj t'i jetë cenuar, nga ana e asaj gjykate, e drejta për t'u dëgjuar e lidhur me pretendimet e saj. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

26. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë ka marrë përsipër të bëjë interpretimin dhe kualifikimin e fakteve dhe provave, gjë të cilën e kanë për detyrë gjykatat e faktit. Ajo gjykatë e ka bazuar vendimin në analizimin e provave, në një kohë kur ajo është gjykatë ligji. Ky fakt vërtetohet nga paragrafi 21 i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

27. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar për një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar

çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj nga ligji (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur për sa më sipër, Kolegji do të analizojë nëse Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të çështjes e ka tejkaluar ose jo funksionin e saj si gjykatë ligji. Referuar kërkesës, kërkuësja, në thelb, e bazon pretendimin e saj te paragrafi 21 i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ku ajo gjykatë shprehet: “*Kolegji, mbështetur mbi të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga gjykatat e faktit, vlerëson se në rastin objekt gjykimi nuk është interpretuar saktë ligji i zbatueshëm dhe, për rrjedhojë, çështja është zgjidhur drejt e në përputhje me dispozitat materiale.*”.

29. Nisur nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se në ndryshim nga sa pretendon kërkuësja, ajo gjykatë nuk ka bërë rivlerësim të fakteve e provave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, përkundrazi, ka zbatuar kompetencat e saj si gjykatë ligji, duke e interpretuar atë mbi të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga gjykatat e faktit. Sikurse ajo gjykatë është shprehur, kontrolli i saj nuk ka konsistuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e faktit, përkundrazi, duke pranuar vlerësimin e tyre për faktet, kontrolli i saj është fokusuar vetëm në drejtim të bazueshmërisë ligjore të vendimit të ankimuar (atij të apelit), duke u bazuar në interpretimin e ligjit material të bërë në arsyetimin e vendimit (*shih paragrafët 24- 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Prandaj, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuëses për cenimin e së drejtës së gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuëses nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.